



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVE



Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr. 02/
Datë: 14.09.2018

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

14-09-2018

02/348

Procesverbal
i mbledhjes se V (pestë) të Komitetit për Politikë dhe Financa

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.
2. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/156 datë: 22.05.2018 të Kryesuesit të Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor i punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë Komunale, për vitin 2017 (Janar-Dhjetor 2017).
4. Shqyrtimi i Raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2018.
5. Shqyrtimi i mundësisë për caktimin e hapësirave për zyrën e kryesuesit të Kuvendit dhe të grupeve politike në Kuvendin e Komunës së Malishevës.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/594 datë:20.04.2018 për shqyrtimin e draft-Planit të Integritetit të Komunës së Malishevës për vitet 2018-2020.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/598 datë: 23.04.2018, për marrjen e vendimit në lidhje me miratimin e draft-dokumentit, Plani i veprimit për Transparencë në Komunën e Malishevës për vitin 2018.
8. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit nr.02/256 datë:05.07.2018, për performancë komunale për vitin 2017.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/253 datë: 03.07.2018 të parashtruar nga z. Sadik Bytyqi nga fshati Millanoviq, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
11. Emërimi i anëtarëve të Komitetit për Barazi Gjinore.
12. Emërimi i anëtarëve të Komisionit për banesat e 32 familjeve në Lagjen Mirditë në Malishevë.
13. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor Janar-Qershor 2018 të punës i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
14. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor i punës për vitin 2018 i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
15. Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.
16. Shqyrtimi i kërkesave.
17. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 22.08.2018, filloj në ora 10, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, përfaqësuesi i OSBE-se, zyra për informim, qytetar.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve fillimisht ju uroje festën e Kurban Bajramit, jemi në mbledhjen e V kemi këtë rend të ditës që ju kemi shpërnda me ftesa.

Alban Krasniqi: Janë tri çështje që dua t'i ngris: javën e Diasporës e kemi kaluar tash por si mundemi me organizuar viteve që vijnë me mirë. Për Odën e Llapushës jam interesuar vet me hulumtuar asnjë vendim nuk kemi nga Komuna për organizimin e këtij festivali, është mirë me caktu me vendim dhe me ba tradicional, në Qershor kemi marr vendim për me paraqit në debat publik Draft rregulloren për tokën bujqësore s'kam informacion a ka ndodhë diçka, afatet kanë kaluar të përcillet kjo çështje të bëhet si lloj presioni.

Rrahim Morina: Rregulloren ja kam dergu drejtorit të Bujqësisë aj nuk ka lëviz tash do të shkoj edhe te Kryetari i Komunës për këtë qeshtje me biseduar, por është obligim i drejtorit me paraqitur në debat publik, sot të gjithë drejtorët i kam ftuar çka kanë pika në rend dite.

Alban Krasniqi: Një kërkesë e kryesisë së fshatit Bubavec që ka qenë për atë kompaninë Guri 6 kërkoj që të futet në rend dite.

Hashim Vrenezi: Disa pika janë diskutuar, si PDK jemi të pa kënaqur me qeverisjen Begaj, kërkesave deri tani nuk ju kanë përgjigjur, bartja e mjeteve të vitit 2017 s'dihet në cilat projekte dhe deri ku kanë shkuar sepse pikërisht për këto kërkesa edhe kemi bojkotuar mbledhjen e kuvendit. Kështu 4 vite me kaluar këta me neglizhuar edhe në funt kta mi marr meritat jo. Një vendim që është marr për sallën e sporteve në fshatin Drenovc ende ska asgjë është në një terr informativ.

Rrahim Morina: Për bartjen e mjeteve MEF ka kërkuar një arsyeshmeri, drejtoria e ka dërguar tash jemi në pritje.

Hashim Vrenezi: Për asnjë kërkesë ne s'kemi marr përgjigje ose t'i heqim pikat e Kryetarit krejt çka janë në rend dite te mbesin çka janë të qytetarëve.

Alban Krasniqi: Nëse ka arsye që kjo qeveri te ndihet komode, por është faji yni e më shumë i juaji Hashim në pikat kyçe mbledhjen e kaluar keni bojkotuar pastaj pas një vendimi politik keni thirr mbledhje te jashtëzakonshme në ditë zije për një pikë me dokumente të dyshimta, sepse qohet dikush i lyp 200 mijë euro pa dhanë ndonjë arsyetim për një projekt e ju po ja bëni argatin kësaj qeverisje. E për çështje parimore e bojkotoni mbledhjen. Duhet strategji veprimi e bashkëpunimi edhe me qytetarë sepse kemi numrat edhe vullnetin, unë jam që krejt pikat çka i sjellë kryetari me i hjekë prej rendit të ditës përveç raporteve si raporti i Auditorit të përgjithshëm.

Rrahim Morina: Ditën kur kemi mbajt mbledhje te jashtëzakonshme në kemi caktuar veç lokacionin por mjete si kemi ndarë, e që atë mbledhje e kemi mbajti në ditë zie nuk kemi bërë mire këtë e dijë.

Hashim Vrenezi: Ka qenë iniciative e asamblistëve që kanë nënshkruar me mbajt mbledhje te jashtëzakonshme, përndryshe përveç pikave tjera raportet duhet t'i debatojmë në Kuvend.

Rrahim Morina: Kemi edhe një kërkesë që ka sjellë Kryetari i Komunës për themelimin e inkubatorit të bizneseve në Malishevë.

Alban Krasniqi: Me këtë kërkesë i kërkojnë 300 mijë euro edhe i gjuajnë në fund në lloç, sepse ky vend ku jemi ka qenë i planifikuar më herët për inkubator, unë nuk jam të futet kjo kërkesë.

Hashim Vrenezi: Pikat që kërkojmë t'i heqim janë pika 6,7 e të futet si pikë raporti i bashkëpunimit mes kuvendit dhe qeverisë komunale.

Valon Krasniqi: Të kemi një konsensus se cilat pika mi hjekë dhe cilat mi lanë në rend dite.

Rrahim Morina: Kush jeni të futet në rend dite propozimi i Hashimit, Raporti i Kuvendit të Komunës dhe qeverisë komunale?

Unanimisht të gjithë ishin për.

Kush jeni që pika 6,7 dhe 9 të hiqen nga rendi i ditës pasi që ka propozime mi hjekë? Unanimisht ishin për.

E kemi një kërkesë tani që na erdhi nga Kryetari Komunës për themelimin e inkubatorit të bizneseve në Malishevë. Kush jeni që kjo kërkesë të futet në rend dite ne këtë mbledhje? Kundër ishin 5 anëtarët e KPF.

Kush jeni për këtë rend ditës me ndryshime? Për ishin unanimisht.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.

Raimonda Krasniqi: Faqe 2 rreshti 6, i kam thënë Kryetarit mos kërko ndihmë për keqpërdorimet e ekzekutivit.

Rrahim Morina: Kush jeni për miratimin e dy procesverbaleve me vërejtje? Unanimisht ishin për miratim.

Kush jeni për këto ndryshime në rend dite pikat: 3,4,5,8,10,11,12 të rekomandohen për kuvend të Komunës? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor Janar-Qershor 2018 të punës i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Alban Krasniqi: Ky raport është dashtë të kaloj përmes Komitetit për Shëndetësi, pastaj te sillet në Kpf. Mirë është te thirrni një mbledhje të Komitetit aty të shqyrtohet ky raport para se te vije tek ne.

Rrahim Morina: Unë kisha thënë këtë herë të shkojnë por nëse ju mendoni mi thirre unë i thërras Komitetet për këto raporte atë të Bujqësisë, Arsimit dhe të Shëndetësisë.

Raimonda Krasniqi: Shqetësim është rasti i fundit që ishte në Liqenin e Mirushës aty dëmtohet flora dhe fauna, sepse kemi dëgjuar se kur është bërë spërkatja ato pompa i kanë shpërla dhe i kanë derdh në lum.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë raport për kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor i punës për vitin 2018 i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Rrahim Morina: Në mbledhje duhet të kërkojmë nga drejtoria t'i sjellë edhe listat e përfituesve të subvencioneve.

Valon Krasniqi: Ju kanë dhanë makina mjelëse njerëzve që nuk kanë hiq lope.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë raport për kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.

Alban Krasniqi: Në mbledhje Drejtoria duhet të na sjellë një liste të Shkollave me drejtoret që kanë aplikuar dhe drejtoret që janë zgjedhur drejtor, pastaj numrin e nxënësve për secilën shkollë, gjininë e tyre dhe ata që kanë braktisur shkollën, të kemi një krahasim sidomos për nxënësit që po braktisin. Kërkoj me ditë sa është numri i pozitave që janë ushtrues detyre.

Valon Krasniqi: Kërkoj të dijë pse në disa shkolla po fshihen orët nuk po shpallen.

Raimonda Krasniqi: Këto janë shqetësime tona dhe mirë është që për këto kërkesa drejtoria të na sjellë me shkrim raport. Për shembull ndër shkollat që kanë përfituar grante shkolla "Hasan Pristina" në Terpezë çka ka përfituar? Në këtë shkollë në vitin 2015/16 një arsimtar i edukatës fizike ka mbajt 3 orë bibliotekë por me ligj janë të caktuar vetëm 2 orë bibliotekë, por ai arsimtar në kohën e zgjedhjeve i ka pas vu disa postera të Ragip Begaj. Në kuvend duhet t'i kemi komplet listat e aplikuesve për drejtor dhe ata që janë zgjedhur numrin e poenave.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë raport për kuvend? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi i kërkesave.

Shqyrtimi i kërkesës nr.02/235 të datës: 27.06.2018 e parashtruar nga Shaban Bytyqi nga fshati Kërvasari, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Alban Krasniqi: Për tokat që janë pyjore kompetent sipas Ligjit dhe sipas draft rregullores që kemi propozuar për token bujqësore është Agjencioni Pyjor i Kosovës.

Rrahim Morina: Në duhet t'i kthejmë përgjigje që ne s'jemi kompetent e pala që ka bere kërkesën le t'i drejtohet Agjencionit Pyjor. Kush jeni që kjo kërkesë në mungesë të kompetencës tonë të refuzohet e palës t'i japim një përgjigje? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.01/1116 datë:27.07.2018 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të z.Aziz Januzaj nga fshati Senik KK.Malishevë.

Rrahim Morina: Kjo kërkesë ka protokoll të zyrës së kryetarit, nëse kryetari na sjellë një kërkesë për Kuvend lidhur me këtë kërkesë pasi që atij ju është drejtuar ne mund ta rekomandojmë. Kush jeni që kjo kërkesë nëse vjen me kërkesë të kryetarit ne ta rekomandojmë? Unanimisht ishin për ta rekomanduar për kuvend.

Kërkesa nr.02/254 të datës 04.07.2018 e parashtruar nga kryesia e lagjes së fshatit Balincë

Rrahim Morina: Këta si kryesi e lagjes kanë kërkuar ndërtimin e një shtëpie për nevojat e lagjes por këtu nuk ceket çështja e pronësisë, ska pëlqim nga kryesia e fshatit, ska as paramasa as parallogarit vetëm disa flete pagesa.

Alban Krasniqi: Orientimi i kryesisë së kësaj lagje është gabim se di a e kanë nis ata këtë objekt apo po dëshirojnë me nisë, pastaj prona a është private apo shtetërore, pastaj duhet leje të Urbanizmit. Është një vendim që 70% që financon Komuna e 30 qytetaret kur kanë kësso iniciativa.

Rrahim Morina: Kush jeni që kryesisë së lagjen të fshatit Balincë t'i kthejmë përgjigje se kërkesa është e pa kompletuar? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/273 datë: 13.07.2018 për marrjen në shfrytëzim të katit të parë të objektit ish Gjykatës Komunale-ana e pasme e hyrjes.

Rrahim Morina: Kjo palë po kërkon atë pjesë të objektit për biznes.

Muharrem Morina: Sa unë jam në njohuri kërkon këtë pjesë të objektit me hap një biznes dhe ka thënë se do të punësojë vetëm femra.

Rrahim Morina: Kush jeni që këtë kërkesë ta dërgojmë për Kryetarin e Komunës pasi që sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim Kryetari duhet të sjellë një arsyeshmeri në kuvend? Unanimisht ishin për.

6. Të ndryshme

Rrahim Morina: Nëse dikush nuk ka diçka atëherë ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11.35 min.

Procesmbajtësi:

Naim Avdijaj jur. i dip

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina

